

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d) dhe nenit 49 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e RK-së", nr.28/2008), nenit 13 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 nga 22.10.2015, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e dytë të rregullt, e mbajtur më datën 26.02.2025, merr këtë:

V E N D I M Nr.07/2025/KG

për miratimin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit, e mbajtur më datën 29.01.2025

Neni 1


Miratohet procesverbali nga mbledhja e parë e rregullt e Kuvendit Komunal, e mbajtur më datën 29.01.2025.


Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është procesverbali nga mbledhja e parë e rregullt e Kuvendit Komunal, e mbajtur më datën 29.01.2025.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit të vendimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.


Kryesuesi i Kuvendit

Mikel Dimitrijević



PROCESVERBALI

Nga mbledhja e parë e rregullt e Kuvendit të Komunës së Graçanicës,

E mbajtur më datën 29.01.2025 në sallën e Kuvendit të Komunës së Graçanicës dhe filloi në orën 10:30.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Graçanicës, Millan Dimitrijeviq, hapi mbledhjen duke i përshëndetur të gjithë të pranishmit dhe shtoi se në mbledhje nga 19 asamblistë morën pjesë 14 asamblistë dhe se ka kuorum, ndërsa mungojnë 5 asamblistë: Ljubisha Karaxhiq, Dushan Borisavljeviq, Sonja Odalloviq, Nebojsa Markoviq dhe Granit Gashi.

Në mbledhje marrin pjesë: përfaqësues i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, drejtoresha e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, koordinatorja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, Shërbimi për Informim dhe Shërbimi për Çështjet e Kuvendit.

Kryesuesi i njoftoi asamblistët se para mbledhjes së sotme të Kuvendit u mbajt mbledhja e parë e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe se komiteti njëzëri e ka dhënë mendimin pozitiv për rendin e ditës të propozuar.

Kryesuesi e vuri në votim rendin e propozuar të ditës:

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 14 asamblistëve “Pro”, miratoi rendin e mëposhtëm të ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e nëntë e rregullt, e mbajtur më datën 27.12.2024.
2. Shqyrtimi dhe miratimi Raportit të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2024, me propozim të kryetares së Komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit vjetor të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2025, me propozim të kryetares së Komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-Vendimit për ndryshimet e miratuara të personelit dhe shumës përkatëse buxhetore për kategorinë e shpenzimeve “Paga dhe shtesa në paga”, me propozim të drejtorit të buxhetit dhe financave, Silavisha Niçiq.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2024, me propozim të Komitetit për Shërbime Publike.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024, me propozim të kryesuesit të Komitetit për Komunitete, Aziz Karadollami.

7. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e nëntë e rregullt, e mbajtur më datën 27.12.2024.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 14 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e parë të rendit të ditës.

Në mbledhje është i pranishëm asamblisti Ljubisha Karaxhiq, gjithsej janë të pranishëm 15 asamblistë dhe ka kuorum.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi dhe miratimi Raportit të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2024, me propozim të kryetares së Komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.

Raportin për punën e KKSBS-së për vitin 2024 e prezantoi koordinatorja e KKSBS-së, Millica Krstiq, e cila tha se KKSBS-ja në vitin paraprak ka mbajtur dy mbledhje të rregullta dhe tri të jashtëzakonshme, ku më pas nga raporti i ka lexuar temat e diskutuara në mbledhjet e KKSBS-së.

Kryesuesi tha se mund të konkludojnë se situata jo e qetë është duke u përkeqësuar, sepse ne vetë e pamë nga shembulli kur shqiptarët festonin festën e flamurit, ku policia nuk reagoi, sepse unë personalisht e kam raportuar incidentin e ndodhur në afërsi të Manastirit të Graçanicës ku nga përfaqësuesit kujdestarë të policisë mora përgjigje se do të më arrestonin nëse edhe një here do të kërkoja që të raportojnë dhe kërkojnë përforcime. Bashkësia ndërkombëtare dhe mbi të gjitha KFOR-i nuk kanë bërë asgjë, sepse nuk janë paraqitur ndërsa kanë ditur përmes shërbimeve të tyre se kush, çfarë dhe si ka bërë.

Asamblistja Snezhana Jovanoviq, para partisë “SRPSKA”, sugjeroi rishikimin e anëtarësimit në KKSBS-së, pasi ekzistojnë 4 organizata joqeveritare të udhëhequra nga gratë që mund të ndihmojnë në çështjet e zgjidhjes së dhunës në familje. Në KKSBS-në janë edhe tre anëtarë që përfaqësojnë tre KLSP, nga të cilët anëtari Simiq më së shumti mungon për shkak të angazhimeve, Todiq nuk është i sigurt në pikëpamjet e tij, ndërsa KLSP-ja që unë e drejtoj duhet të forcohet, sepse nuk ka anëtarë që duan të jenë aktiv sepse gjithçka është në nivel vullnetar. Në Stacionin policor të Graçanicës ka shumë policë shqiptarë, edhe pse Komuna e Graçanicës ka popullatë shumicë serbe. Ne duam me kritika pozitive të ndikojmë që policia të jetë më e mirë, ndërsa jo ti pengojmë në punën e tyre, ndërsa policia që duhet të jetë bashkëbiseduesi ynë i parë nuk është në ndihmë dhe as faktorët ndërkombëtarë nuk janë të pranishëm në territorin e Komunës së Graçanicës.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 15 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e dytë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit vjetor të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2025, me propozim të kryetares së Komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.

Koordinatorja e KKSBB-së, Millica Krstiq, tha se KKSBB-ja është e obliguar që ta hartojë planin vjetor të KKSBB-së dhe ta dorëzojë në Kuvendin e komunës për miratim. Planin për vitin 2025 është identik me planin për vitin 2024.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 15 asamblistëve "Pro", miratoi pikën e tretë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-Vendimit për ndryshimet e miratuara të personelit dhe shumës përkatëse buxhetore për kategorinë e shpenzimeve "Paga dhe shtesa në paga", me propozim të drejtorit të buxhetit dhe financave, Sllavisha Niçiq.

Drejtori i buxhetit dhe financave, Sllavisha Niçiq, tha se në buxhetin e vitit 2025 në programin e shërbimeve sociale kemi 4 vende të aprovuara të punës dhe një buxhet pagash prej 28.989 euro. Ne kërkojmë që numri i të punësuarve të rritet edhe me një vend pune: "Udhëheqës i Qendrës për Punë Sociale (Drejtor i QPS)". Këtë pozitë më parë e ka mbajtur një zyrtar, i cili nuk është më në detyrë dhe për shkak të kërkesave ligjore nuk kemi mundur t'i paguajmë kompensimin për kryerjen e asaj pozite. Bazuar në nenin 12 dhe nenin 15 të Ligjit nr.08/L-332, mund të kërkojmë miratim nga ministri, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, për rritjen e një pozite.

Kryesuesi pyeti a ka komuna mjete financiare për atë pozitë.

Drejtori i buxhetit dhe financave, Sllavisha Niçiq, u përgjigj se komuna do të merrte mjete nga një program ku ata kanë më shumë mjete.

Asamblisti Vlladica Qurçiq, para partisë "SRPSKA", pyeti a do të shpallet konkurs për këtë pozitë.

Drejtori i buxhetit dhe financave, Sllavisha Niçiq, u përgjigj se komuna do ta shpallë konkursin nëse ministri e miraton propozimin.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 15 asamblistëve "Pro", miratoi pikën e katërt të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2024, me propozim të Komitetit për Shërbime Publike.

Asamblisti Stefan Mitroviq, para partisë "SRPSKA", tha se ai do të prezantojë raportin, pasi është anëtar i Komitetit të Shërbimeve Publike. Komiteti ka mbajtur dy mbledhje të jashtëzakonshme gjatë vitit 2024. Në mbledhjen e parë rendi i ditës u përcaktua si më poshtë: Rehabilitimi i gropave; Ndriçimi dhe sinjalizimi i rrugëve; Informatat për gjendjen e rrjetit të ujësjellësit, ku drejtori i shërbimeve publike foli për gjendjen në terren, në radhë të parë për kanalet e shiut, shtretërit e lumenjve dhe deponitë ilegale. Është mbajtur mbledhja e dytë e jashtëzakonshme lidhur me prezantimin e draft Planit Operativ Lokal për Veprime në Situata

Emergjente. Ky dokument duhet të përmbajë një plan reagimi, gjegjësisht mbrojtje dhe shpëtim në situata të ndryshme, ndërsa komuna ka publikuar thirrje publike për hartimin e këtij dokumenti dhe është formuar një grup punues, i cili përfshin sektorin joqeveritar. Pas dorëheqjes së asamblistit Marko Arsiq, i cili gjithashtu është edhe anëtar i Komitetit për Shërbime Publike, në vend të tij u emërua asamblisti Nebojsa Marković.

Asamblisti Ljubisha Karaxhiq, para partisë "SRPSKA", pyeti nëse Komuna e Graçanicës është përgjegjëse për vendosjen e shenjave të komunikacionit në territorin e Komunës së Graçanicës.

Kryesuesi u përgjigj se Komuna e Graçanicës është përgjegjëse.

Asamblisti Ljubisha Karaxhiq, para partisë "SRPSKA", tha se është vonuar në mbledhjen e sotme sepse policia i ka shkruar një gjobë për mosrespektimin e kalimit në urën në Llapllasellë ku dikush i kishte hequr shenjën e trafikut për kalim të drejtë. Ai sugjeroi që në atë lokacion të vendoset sinjalistika e komunikacionit, si dhe në të gjithë territorin aty ku është e nevojshme.

Kryesuesi po ashtu e theksoi problemin në Graçanicë tek rrethrotullimi, i cili nuk është rrethrotullim, ku nuk ka sinjalistikë të komunikacionit dhe ku shpesh ndodhin aksidente, sepse disa vozitës mendojnë se kanë përparësi sepse dalin nga rrethrotullimi në rrugë kryesore. Aktualisht kemi rrugë të mbushura me baltë dhe gropa dhe mendoj se ndriçimi i rrugëve në vende të tjera, përveç në Graçanicë, nuk funksionon siç duhet. Duhet të kërkojmë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Urbanizmit që të bëjnë diçka për këto probleme.

Asamblistja Snezhana Jovanović, para partisë "SRPSKA", tha se në mbledhjen e kaluar të Kuvendit ka kërkuar dhe tani kërkon që urgjentisht të shënohet parkingu pranë Qendrës së shkollave të mesme, nëse është e nevojshme të krijohet një ishull dhe të vendoset një rampë për të garantuar siguri për të gjithë. Ajo sugjeroi që Drejtoria e Shërbimeve Publike të komunikojë me përfaqësues të Këshillave lokale për të marrë informacione prej tyre për problemet lokale. Mendoj se asamblistët nuk duhet të jenë të etiketuar që nuk marrin pjesë në debatet kur diskutohet për buxhetin, sepse asamblistët bëjnë sugjerime gjatë gjithë vitit në mbledhjet, pastaj paraqesin disa kërkesa me shkrim, si dhe i përfshijmë edhe këshillat lokale dhe KLSP dhe nga kryesuesi i Kuvendit kërkojmë zgjidhjen e problemit përmes organit ekzekutiv.

Asamblistja Sllagjana Rashiq, para partisë "SRPSKA", vuri në dukje problemin se njëra anë e rrethojës mbrojtëse në urën në rrugën "Kajmakçallanska" është rrënuar.

Kryesuesi propozoi që në mbledhjen e radhës të ftohet drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Asamblisti Vlladica Qurçiq, para partisë "SRPSKA", tha se do të kërkojë përgjigje nga drejtori Trajković në pyetjen "Kur janë shpallur tenderët, kush i ka shpallur dhe pse janë vonuar tashmë një vit e gjysmë? Nëse tenderat nuk janë shpallur, kërkoj që ai që nuk i ka shpallur të mbajë përgjegjësi". Ai u ankua se komuna nuk i punon prioritetet, duke përmendur shembullin e një rruge gati të asfaltuar në Dobrotin me vetëm një shtëpi, ku jeton vetëm një person dhe atë në fundjavë, ndërsa rruga kryesore ka mbetur me shumë gropa. "Me sugjerimin tim, nja dy gropa u mbushën një herë, jo të gjitha, por ato gropa u hapën sërish. Gropa ka edhe drejt Livagjes, Janjevës, Sushicës, etj".

Asamblisti Stefan Mitroviq, para partisë “SRPSKA”, shtoi se drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike është përgjegjës për disa fusha, por Urbanizmi është më përgjegjës për zgjidhjen e problemeve që i kemi renditur, prandaj në mbledhjen e radhës të Komitetit të Shërbimeve Publike, përveç drejtorit të shërbimeve publike, do ta ftojmë edhe drejtoreshën e Urbanizmit për të marrë përgjigje ndaj këtyre pyetjeve.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 15 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e pestë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024, me propozim të kryesuesit të Komitetit për Komunitete, Aziz Karadollami.

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Aziz Karadollami, tha se në vitin 2024, Komiteti për Komunitete ka mbajtur 9 mbledhje të rregullta dhe 3 të jashtëzakonshme. Në çdo mbledhje, Komiteti, përveç anëtarëve të tij të përhershëm, ftonte edhe përfaqësues të Stacionit policor të Graçanicës dhe në këtë mënyrë u koordinua për çështjet e sigurisë ndërmjet përfaqësuesve të të gjitha komuniteteve. Janë ftuar rregullisht edhe drejtorët e drejtorive përkatëse për informata specifike lidhur me detyrat e tyre. Më pas ai i lexoi nga raporti i bashkëngjitur të gjitha problemet, propozimet dhe sugjerimet e ngritura nga anëtarët e Komitetit për Komunitete.

Asamblistja Jellena Dimitrijeviq, para partisë “SRPSKA”, tha: “Se kemi vite që flasim për të njëjtat probleme në mbledhjet e Komitetit për Komunitete, por nuk kemi bërë asgjë, nuk kemi ndryshuar asgjë për mirë, gjërat janë duke u përkeqësuar dhe nuk e di se cili është qëllimi ynë”.

Kryesuesi u përgjigj se qëllimi i Komitetit për Komunitete është që t'i vërë në dukje Kuvendit disa probleme, mirëpo për shkak se ligjet në Kosovë nuk respektohen nga autoritetet qendrore, konfuzioni i përgjithshëm është bartur nga autoritetet qendrore deri në fund. Kur nuk mund të koordinohesh me stacionin policor për disa gjëra, sepse në tërë territorin e Komunës së Graçanicës janë vetëm 4 policë në turnin e natës në 17 vendbanime. Kemi pasur një rast ku ka ndodhur një grabitje pranë Stacionit të policisë dhe nuk lejohen të dalin nga ndërtesa sepse do të ndëshkohen. Nuk kam dyshim se Komiteti për Komunitete ka përcjellë kërkesa të shumta dhe sigurisht vetëm ato më të rëndësishmet janë përmendur në raport.

Asamblistja Jellena Dimitrijeviq, para partisë “SRPSKA”, tha se shumë nuk janë përmendur, siç është problemi me qentë endacakë.

Kryesuesi tha se për problemin me qentë endacakë flitet që tetë vite dhe ne kemi kërkuar nga drejtori i atëhershëm i Bujqësisë, Dragisha Stojanoviq, që ta zgjidhë problemin me qentë endacakë. Në vend të tij u emërua Nebojsa Nikolliq, i cili nuk u paraqit në mbledhjet e Kuvendit dhe tani në vend të tij është emëruar një drejtor i ri.

Asamblistja Jellena Dimitrijeviq, para partisë “SRPSKA”, ”, tha se në 4 vitet e fundit nuk është zgjidhur asgjë, ndërsa para kësaj diçka është zgjidhur përmes Komitetit.

Asamblistja Snezhana Jovanović, para partisë “SRPSKA”, tha se ia ka dërguar kërkesën drejtorit të Ekologjisë me një video, në të cilën ka treguar se ku duhet të vendosen shportat e mbeturinave apo ndërrimet e tyre në Graçanicë dhe ka sugjeruar që Komiteti për Komunitete të vazhdojë të kërkojë zgjidhje për këtë problem në mbledhje.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 15 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e gjashtë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Të ndryshme.

Asamblisti Ljubisha Karaxhiq, para partisë “SRPSKA”, i informoi asamblistët se kolegu – asamblisti Dushan Borisavljeviq kishte një operacion në Kubë, se ai është mirë dhe do të kthehet më 13 shkurt dhe sugjeroi që asamblistët ta ndihmojnë financiarisht Borisavljeviqin.

Kryesuesi tha se asamblistët duhet t'i dorëzojnë mjetet monetare në Shërbimin e Kuvendit, ndërsa për diçka më të madhe duhet të marrim pëlqimin e tij.


Asamblisti Vlladica Qurçiq, para partisë “SRPSKA”, tha se mediat e kishin publikuar lajmin se komuna nuk po e ndihmon Shoqatën e personave me nevoja të veçanta dhe sugjeroi që t'i dërgohet një kërkesë komunës duke kërkuar që shoqatës t'i jepet mbështetje dhe ndihmë dhe t'u ndahen mjetet financiare si dhe se këtu duhet të përfshihet edhe Komiteti për personat me nevoja të veçanta.

Asamblisti Millosh Dimiq, para partisë “SRPSKA”, tha se është anëtar i Komitetit për persona me nevoja të veçanta dhe se shoqatat kanë kërkuar ndihmë prej tyre dhe se komiteti e ka njoftuar Kabinetin e kryetares për kërkesën, ku kanë marrë përgjigje se komuna nuk ka mjete financiare për ta ndihmuar Shoqatën.

Pasi që askush nuk e mori fjalën për të diskutuar lidhur me pikën “Të ndryshme” të rendit të ditës, kryesuesi falënderoi për bashkëpunim dhe mbledhja mbaroi në orën 11:37.

Procesmbajtësi:

Agron Karadollami



Kryesuesi i Kuvendit Komunal
Milan Dimitrijević